

Dorđe Božović

Fakulteti Filologjik të Beogradit

Roli i sinkretizmit në sistemin rasor të shqipes¹

Ky punim merret me sistemin rasor të emrave të shqipes nga pikëpamja e sinkretizimit të formave të emërores dhe të kallëzores, nga një anë dhe të dhanores e të rrjedhore nga ana tjetër. Edhe pse sinkretizmi i rasave – kryekreje ai i rasës gjinore me dhanoren – njihet në të gjitha gjuhët e Lidhjes gjuhësore të Ballkanit, gjuha shqipe dallohet dukshëm nga gjuhët e tjera ballkanike për shkak të një numri më të madh të rasave, si dhe për ekzistencën e nyjave të përparme, por edhe për shkak të rolit që e luan sinkretizmi në sistemin rasor të saj. Ky rol analizohet nga aspekti formal, duke pasur parasysh lidhjen formale mes kategorive morfologjike të rasës dhe të shquarsisë tek emrat, si dhe nga aspekti funksional (morfosintaktik), ku bëhet fjalë për ekonominë gjuhësore, duke treguar se si është përdorur sinkretizmi në sistemin rasor të shqipes si mjet për të mbajtur ekonominë maksimale mes formave të ndryshme të rasave dhe të trajtave të shquara e të pashquara të emrit, në raport me funksionet e caktuara sintaksore të tyre në gjymtyrët përkatëse të fjalisë. Kështu, në sistemin rasor të emrave të shqipes dallohen formalisht vetëm nga tri trajta të ndryshme të rasave të emrit që janë funksionalisht të domosdoshme në secilën paradigmë, d.m.th. në lakimin e pashquar të emrit fshihet dallimi formal në mes të rasave emërore dhe kallëzore për shkak të jodomosdoshmërisë së tij për sintaksën e emrit, kurse në lakimin e shquar fshihet dallimi midis dhanores dhe rrjedhore, sërish për shkak të jodomosdoshmërisë funksionale të atij dallimi.

Fjalët kyçe: sistemi rasor, sinkretizmi, gjuha shqipe, emri, morfosintaksa e lakimit.

“Është përsëritur sa herë” – shkruan në një vend tashmë i ndjeri profesor Idriz Ajeti (1917–2019), i cili në ndërkohë ndërroi jetë dhe të cilit i kushtoj këtë punim – “që shqipja ka krijuar një sistem deklinacioni analitik duke kryer një thjeshtim dhe sinkretizim trajtash rasore. Gjuha shqipe ka gjashtë

¹ U jam shumë mirënjohës profesoreshave Merima Krijezi, Lindita Sejdiu-Rugova dhe Giuseppina Turano, si dhe Gladiola Durmishi (Elezi), që e moderoi seksionin, për komentet e tyre të vlefshme gjatë diskutimit në seksionin gjuhësor të konferencës ku u prezantua ky punim.

rasa nga tetë, sa kishte paragjuha mëmë indoevropiane [duke përfshirë këtu rasën vendore], por edhe ato të gjashtat rasa nuk dalin me trajta të dallueshme njëra nga tjetra, sepse emërorja e kallëzorja [me përjashtim të trajtës së shquar numri njëjës], pastaj gjinorja me dhanoren dhe rrjedhoren njëjës e shumës, nuk paraqiten të diferencuara morfologjikisht, në qoftë se [s']kemi parasysh përdorimin alternativ të rrjedhores së pluralit në sistemin emëror të lakimit të pashquar [...] Mirëpo, një gjë e tillë në punën e mospërputhjes së trajtave emërore në kuptimin linguistik nuk peshon aq, sepse që të gjitha trajtat e rasave për nga vështrimi i tyre janë të dallueshme” (përshtatur nga autori prej Ajeti 2017: 340).

Pikërisht në çfarë mënyre është organizuar sistemi i lakimit i shqipes së sotme, në mënyrë që pesë rasa të saj (duke përjashtuar këtu vendoren) të jenë të dallueshme “për nga vështrimi i tyre”, megjithëse shumica janë të padallueshme morfologjikisht, do të jetë tema e këtij punimi. Në fillim do të jetë fjala për sistemin e lakimit të shqipes së sotme në përgjithësi, pastaj do të marrim parasysh veprimin e sinkretizmit në sistemin rasor të kësaj gjuhe, dhe në veçanti atij të kallëzores me emëroren nga një anë edhe të rrjedhores me dhanoren nga ana tjetër, dhe në fund do të japim arsyetime për rolin që e luan sinkretizmi në rrafshin morfosintaktik të lakimit të gjuhës shqipe. Tregohet se sinkretizmi i rasave në gjuhën shqipe është motivuar funksionalisht, prandaj emri nuk ka nevojë për t’i pasur trajtat e caktuara rasore të dallueshme formalisht, sepse ato përdoren me funksione të ndryshme sintaksore, pra, “për nga vështrimi i tyre janë të dallueshme”. Sinkretizmi rasor bëhet kështu një mjet formal i morfologjisë së shqipes për të mbajtur ekonominë e gjuhës maksimale në paradigmën morfologjike, si një tipar karakteristik i gjuhës shqipe gjatë tërë historisë së saj. Në të njëjtën kohë, kjo tregon për një lidhje të ngushtë mes morfologjisë dhe sintaksës.

Sistemi i lakimit i shqipes së sotme është tërësisht inovativ. Siç e përshkruan Çabej, në mënyrë mjaft piktoreske: “Lakimi i shqipes ka pësuar ndryshime të mëdha sidomos në sistemin e rasave, kështu ndër të tjera, siç ka vënë re Pedersen, humbjen e instrumentalitetit; më anë tjetër ka pasur formime të reja me mbarese të reja, ndër to të ashtuquajturën vendore (lokativ) më -t njëjës, e më në fund ka ndodhur një sinkretizim i shpeshtë, një përzierje e rasave, e mbareseve dhe e funksioneve sintaktike të tyre” (Çabej 1955: 46). Tek emrat, dukuria ndoshta më e rëndësishme për formimin e sistemit të sotëm të lakimit është shfaqja e nyjave të shqipes, siç e thekson ndër tjerash edhe Topalli: “Sistemi i lakimit të emrave të shqipes ka bërë ndryshime të mëdha në krahasim me sistemin e lashtë indoevropian, aq sa ai paraqitet tërësisht i riorganizuar. Ndryshimi më i rëndësishëm, që e ka transformuar rrënjësisht këtë sistem, është shfaqja e nyjave, që kanë depërtuar thellë në sistemin e lakimit të emrave. Veç këtij ndryshimi, ka pasur zhdukje të disa rasave e

krijime rasash të reja, zëvendësime formash rasore dhe veprim të fuqishëm të sinkretizmit, rënie të mbaresave të trashëguara dhe krijime mbaresash të reja” (Topalli 2007: 211; për më shumë rreth formimit diakronik të sistemit të lakimit të shqipes, khs. Bokshi 2005).

Emri, në gjuhën e sotme shqipe, ka katër kategori morfologjike (gramatikore): ajo e gjinisë, e numrit, e shquarsisë ose e pashquarsisë dhe e rasës (khs. Agalliu et al. 2002: 81–132). Sipas Booij (1994; 1996), kategoritë e fleksionit në përgjithësi mund të ndahen në dy lloje: ato të fleksionit të brendshëm (inherent) dhe ato të fleksionit të jashtëm (kontekstual). Fleksioni i brendshëm i fjalës nuk varet nga përdorimi i saj në kontekstin e fjalisë, d.m.th. është kuptimor e jo lidhur me ndonjë funksion gramatikor. Nga ana tjetër, fleksioni i jashtëm i fjalës (ose fleksioni kontekstual) është varur nga konteksti sintaksor në të cilin përdoret fjala, d.m.th. i është imponuar fjalës nga jashtë, nga struktura e fjalisë. Tek emrat, si kategoritë e brendshme mund t’i konsiderojmë kategorinë e gjinisë dhe atë të numrit, sepse ato të dy janë kuptimore më shumë sesa gramatikore dhe janë kategoritë përcaktuese (klasifikuese), d.m.th. çdo emër i përket leksikalisht një gjinie, e cila ia përcakton tipin e lakimit, kurse kategoria e numrit e përcakton trajtën e bazës (temës) gramatikore të emrit (p.sh. *njeri*- : *njerëz*-, *vajzë*- : *vajza*-), së cilës më në fund do t’i bashkohen mbaresat rasore dhe nyja e prapme. Nga ana tjetër, kategoria e rasës në gjuhën shqipe është, në tërësi, kategoria e fleksionit të jashtëm (fleksionit kontekstual) të fjalës, sepse trajta rasore e emrit është përcaktuar vetëm nga funksioni sintaksor që e ka emri kur futet në fjali apo në ndonjë togfjalësh.

Kategoria e shquarsisë gjendet diku në mes të këtyre dy llojeve të fleksionit. Ajo posedon edhe disa cilësi kuptimore (siç është p.sh. aftësia e saj të bartë kuptimin e individualizimit, shih tek Agalliu et al., op. cit.: 121, 123, dhe në vijim), por varet edhe nga funksioni dhe konteksi sintaksor i emrit (shih edhe më poshtë).² Për shkak të kësaj, duhet folur ndoshta për një kontinuum si në (1) e jo për një dallim aq kategorik midis dy llojeve të fleksionit, ku të katër kategoritë emërore në gjuhën shqipe renditen sipas varësisë ndaj kontekstit sintaksor, nga ajo totalisht e pavarur, si gjinia, deri tek ajo totalisht e varur, si rasa.

(1) gjinia >> numri >> (pa)shquarsia >> rasa

² Për këtë arsye, përdorimi i trajtës së shquar dhe të pashquar të emrit paraqet edhe një nga vështirësitë më të mëdha në përvetësimin e shqipes si gjuhë e huaj (shih p.sh. Krijezi & Mutavdžić, në këtë vëllim). Pikërisht kategoritë e brendshme morfologjike rregullisht paraqiten si më të ndërlikuara kuptimisht dhe më të vështira për ta përvetësuar nga folësit e gjuhëve të tjera, sesa kategoritë e jashtme, që janë diktuar në tërësi nga struktura të tjera gramatikore (khs. edhe Krijezi 2017).

Kontinuumi (1) mund të kuptohet edhe si skematizim i një procesi diakronik i gramatikalizimit të lakimit, i cili ende është në zhvillim, ku tregohet pikërisht se si u gramatikalizua kategoria e (pa)shquarsisë në këtë kontinuum për të “depërtuar thellë në sistemin e lakimit të emrave”. Nga aspekti formal, nyjat e shquara në një pjesë të madhe të lakimit u bashkëshkrinë me mbaresat rasore, ndaj dhe nuk mund të ndahen më. Edhe nga aspekti funksional, shquarsia u ndërlidh me disa funksione të rasave, si p.sh. te plotësuesi i parafjalëve *nga* dhe *te(k)*. E njëjta gjë duket se ka ndodhur edhe te gjinia dhe numri, si kategoritë e brendshme morfologjike, te të cilat mund t’i gjejmë edhe mbaresat e tilla si *-e*, që është në të njëjtën kohë mbaresa e numrit shumës dhe e gjinisë femërore, kështu që ndryshon jo vetëm numrin por edhe gjininë e emrit (*send i ri*, por *send-e të reja*). Veprimi i gramatikalizimit, kështu, ka fshirë deri diku kufirin në mes të kategorive morfologjike të emrit në gjuhën shqipe, duke i çuar në drejtim të një kontinuumi fuzional, me dy pole, si në (2).

(2) gjinia/numri >> (pa)shquarsia/rasa

E rëndësishmja këtu është pozita e kategorisë së (pa)shquarsisë, e cila zë, në të njëjtën kohë, vendin qendror në këtë zhvillim, duke i lidhur kategoritë e brendshme (kuptimore) me ato sintaksore, por edhe duke iu afruar më shumë këtyre të fundit dhe duke e çuar kështu tërë sistemin gradualisht në këtë drejtim gramatikalizimi. Dhe sinkretizimi i formave të ndryshme, ndër të tjera, është një mënyrë se si vepron dhe ka vepruar historikisht ky gramatikalizim, edhe një mjet i tij.

Për nevojat e analizës sonë, ne do të përcaktojmë shquarsinë disi ndryshe nga gramatika tradicionale. Domethënë, në gramatikën tradicionale emri konsiderohet të jetë i shquar vetëm kur del me mbaresa të shquarsisë (nyjat e prapme, si p.sh. *njeri-u*, *vajz-a*, *njerëz-it*, *vajza-t* në rasën emërore), ndërsa konsiderohet të jetë i pashquar, sipas analogjisë, zakonisht kur del me nyjen e pashquar të përparme (të tipit *një njeri*, *një vajzë*, *disa/ca njerëz*, *disa/ca vajza*). Por në gjuhë ekzistojnë jo vetëm këta dy tipe emrash, por edhe tipi i tretë i shquarsisë, i cili përfshin emrat e shquarsisë “zero”, emrat që nuk dalin me asnjë nyje apo mbaresë (d.m.th. *njeri*, *vajzë*, *njerëz*, *vajza*) dhe që përdoren p.sh. si kallëzuesori ose si plotësuesit e parafjalëve. Khs. shembuj në (3).

(3) a. *Vjollca është studente.*

b. *Shanset që të bëheni me djalë apo me vajzë janë 50:50.*

Për nga aspekti gramatikor, prania ose mosprania e shquarsisë tek emri është më me rëndësi sesa dallimi tradicional midis nyjave me kundërvënje kuptimore. Të kihet parasysh se emrat me nyjën “zero”, si në (3), dhe emrat me

çfarëdo nyje gjenden në shpërndarje plotësuese (komplementare), ndërsa emrat me nyjën gati gjithmonë janë të ndërkëmbyeshëm gramatikisht në kontekstet e njëjta (khs. 4a dhe 4b, për ndryshim nga emri pa nyjën në 4c). Vetëm kuptimin e kanë të ndryshëm. Për shkak të kësaj, ka arsye t'i konsiderojmë emrat me nyjën “zero”, si në (3), si emra realisht të *pashquar*, kurse emrat me nyjën, qoftë të prapme, qoftë ato të përparme, si emra *gramatikisht të shquar*, pa marrë parasysh tani dallimin kuptimor në mes të tyre.

- (4) a. *Vajz-a është e mençur.*
- b. *Një/kjo vajzë është e mençur.*
- c. **Vajzë është e mençur.*

Pra, nëse emri del pa morfema të shquarsisë, d.m.th. me shquarsinë “zero”, për nga aspekti gramatikor, është emri i pashquar. Përndryshe, nëse emrit i bashkohet cilado morfemë e shquarsisë, qoftë mbaresa e rasës/shquarsisë ose nyja e prapme, qoftë nyja e përparme, prandaj është emër gramatikisht i shquar, për shkak se prania e morfemës së shquarsisë kërkohet nga vetë gramatika në kontekste të caktuara, dhe përdorimi i morfemës së caktuar (p.sh. i mbaresës/nyjes -a në 4a ose i nyjes *një* në 4b) varet nga kuptimi. Ashtu si nyjat e përparme sillen gramatikisht edhe përemrat dëftorë (*kjo vajzë, këto vajza*) dhe pyetës (*cila vajzë*), numërorët (*dy vajza*; të kihet parasysh se edhe nyja e pashquar *një* me prejardhje është numëror) edhe demonstrativet e tjera, që kurrë nuk mund të vijnë bashkë me mbaresën e shquarsisë tek emri i njëjtë (**ajo vajza, *ato/këto vajzat, *cila vajzat* etj.), d.m.th. janë në shpërndarje plotësuese sepse i përkasin kategorisë së njëjtë funksionale, pra kategorisë së shquarsisë (në kuptimin gramatikor). Nga ana tjetër, pashquarsia për ne thjesht do të thotë *mosprania formale e shquarsisë*, pra emri me nyjën “zero”.

Kjo është e rëndësishme për ta kuptuar mirë rolin e (pa)shquarsisë në sistemin e lakimit të shqipes, duke përfshirë këtu sinkretizmin e formave rasore. Për sa i përket funksionit të rasave, është me rëndësi vetëm nëse emrit i bashkohet ndonjë morfemë e shquarsisë (ose ndonjë dëftor) apo jo, sepse emrat e pashquar (d.m.th. ata të tipit *njeri, vajzë*, me nyjën “zero”) dhe emrat gramatikisht të shquar (pra, të tipit *njeri-u, vajz-a* ose *një/ky njeri, një/kjo vajzë, njerëz-it, vajza-t, disa/dy njerëz* etj.) përdoren në kontekste të ndryshme dhe formojnë kundërvënien gramatikore. Me përjashtim të rasës gjinore, e cila dihet se formalisht është sinkretizuar me dhanoren, plus nyja e përparme, sistemi i rasave i gjuhës shqipe karakterizohet nga totalisht katër trajta të mundshme flektive të emrit – emërorja, kallëzorja, dhanorja dhe rrjedhorja – me mbaresë të ndryshme për numrin njëjës dhe shumës, si dhe në varësi nga shquarsia e emrit të çdo gjinie; por në asnjë kombinim të mundshëm të këtyre kategorive morfologjike – d.m.th. në asnjë paradigmë të emrit – nuk dallohen

të gjitha katër rasat e përmendura formalisht, për shkak të sinkretizimit të tyre (shih tabelën më poshtë).

	Njëjës		shumës	
	e pashquar	e shquar	e pashquar	e shquar
emërore	njeri / vajzë	njeri-u / vajz-a	njerëz / vajza	njerëz-it / vajza-t
kallëzore		njeri-u-n / vajzë-n		
dhanore	njeri-u / vajz-e	njeri-u-t / vajzë-s	njerëz-ve / vajza-ve	
rrjedhore			njerëz-ish / vajza-sh	

Tabela 1. Ilustrimi i lakimit të emrave në gjuhën shqipe.

Siç shihet në tabelë, numri maksimal i formave të ndryshme rasore të emrit në gjuhën shqipe është tre. Në një pjesë të madhe të eptimit, emërorja dhe kallëzorja janë sinkretizuar në një anë, si dhe dhanorja dhe rrjedhorja në anën tjetër. Forma e rasës kallëzore dallohet morfologjikisht nga emërorja vetëm në lakimin e shquar njëjës, me anë të morfemës *-n* (pa dallim gjinie); ndërsa rasa rrjedhore dallohet formalisht nga dhanorja vetëm në lakimin e pashquar shumë, përmes morfemës së pluralit *-sh*. Kjo do të thotë se e rëndësishmja për shfaqjen e rasave formalisht të dallueshme kallëzore dhe rrjedhore brenda paradigmës është pikërisht – kategoria e (pa)shquarsisë, d.m.th. kundërvënie funksionale të saj që janë ndërlikuar edhe me kategorinë morfologjike të rasës dhe me funksionet e rasave, siç e theksuam edhe më lart.

Domethënë, kur shihen funksionet sintaksore të formave të ndryshme të emrit nga tabela 1, bie në sy se si kundërvëniet funksionale në mes të tyre lidhen saktësisht me format e ndryshme, pra me kundërvëniet formale (morfologjike). Emri i shquar, në rasën emërore, tipikisht përdoret si kryefjala ose si plotësuesi i parafjalëve nga e *te(k)*. Në këto kontekste gramatikore s’mund të përdoret trajta e pashquar (d.m.th. me nyjën “zero”) e emrit.³ Krahës shembujve në (4), sh. edhe njëherë (5), me formën e duhur në (5a) ose në (5b), por jo edhe në (5c). E njëjta vlen edhe për emrat pas parafjalëve nga e *te(k)*: nga *Prishtin-a*, *te shokë-t* etj. (*nga *Prishtinë*, **te shokë* etj.).

- (5) a. *Njeri-u* i përket familjes së madhe të majmunëve.
 b. *Çdo njeri* (**çdo njeriu*) i përket familjes së madhe të majmunëve.
 c. **Njeri* i përket familjes së madhe të majmunëve.

³ Kjo është pasoja e “efektit të shquarsisë”, ku sintagma emërore duhet të jetë gramatike dhe shquar për t’u bërë kryefjala e fjalisë, efekti ky i njohur nga literatura gjuhësore, por i diskutuar edhe nga Turano (në këtë vëllim) në kontekstin e dallimit midis fjalive lokative dhe ekzistenciale të shqipes.

Emri i pashquar, nga ana tjetër, përdoret tipikisht si kallëzuesori ose si plotësuesi i parafjalëve të rasës kallëzore, siç u tha edhe më lart (sh. 3). Forma e kallëzores, me mbaresën *-n* të trajtës së shquar, mbetet për funksionin e kundrinorit të drejtë, natyrisht në kontekste gramatikisht të përcaktuara, p.sh. kur emri del me ndonjë përcaktor ose kur përcaktohet nga ana e rimarrjes së kundrinave (*e pashë vajzë-n*, *shoh vajzë-n e re* etj.), kurse në kontekste të papërcaktuara (që shpesh janë idiomatike) sërish vjen trajta e pashquar (*dikë e kam shok*, *kam uri*, *marr fund* etj.).

Kjo do të thotë se midis emërores dhe kallëzores në gjuhën shqipe ekziston një ndarje e punës⁴, ku vetëm tri trajta morfologjike të dallueshme të emrit, njëra prej të cilave është e pashquar dhe dy të tjera janë morfologjike të shquara (*njeri*, *njeri-u*, *njeri-u-n* apo *vajzë*, *vajz-a*, *vajzë-n*), janë të mjaftueshme për të plotësuar funksionet e nevojshme sintaksore të këtyre dy rasave, ashtu që format morfologjike të njëjta (të sinkretizuara) shpërndahen në kontekste të ndryshme funksionale, duke evituar kështu moskuptimin dhe duke u organizuar në mënyrë optimale, gjë që sigurisht s'do të ishte e mundur pa kontributin e kategorisë së shquarsisë për sistemin e rasave të shqipes.

E njëjta gjë vlen për sinkretizmin e dytë të lartpërmendur, ai i rasës rrjedhore (edhe gjinore) me dhanoren. Dhanorja përdoret tipikisht në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë, ndërsa rrjedhorja vjen si plotësues i parafjalëve të shumta ose si përcaktor i një emri tjetër. Pikërisht për shkak se vazhdimisht përdoren në funksione të ndryshme, këto rasa filluan të sinkretizohen dhe dalin sot me një formë të njëjtë. Me fjalë të tjera, sistemi i lakimit të shqipes s'ka nevojë t'i ketë trajtat morfologjike të ndryshme për këto rasa sepse ato kurrë s'përdoren në kontekste të njëjta gramatikore. Kështu vepron ekonomia e gjuhës, e cila në gjuhën shqipe është çuar deri në maksimum. I vetmi rast i konkurrencës midis rasave gjendet te funksioni i përcaktorit, ku gjinorja e rrjedhorja konkurrojnë për të njëjtin funksion. Po sërish vepron ndarja e punës, e mbështetur në kategorinë e shquarsisë, ku forma e gjinores (pra, forma me nyjë) vjen si përcaktori i emrave të shquar dhe rrjedhorja e pasinkretizuar me dhanoren (d.m.th. forma me *-sh*) përdoret si përcaktori i emrave të pashquar (khs. *vaj ulliri*, *dru lisa-sh* : *vaj-i i ullirit*, *dru-ri i lisave*; jo **vaj-i ulliri*, **dru-ri lisa-sh*, **vaj i ullirit*, **dru i lisave* etj.). Për këtë arsye rrjedhorja është e pasinkretizuar me formën e dhanores/gjinore vetëm në trajtën e pashquar numri shumës (sh. tabelën), sepse saktësisht në këtë funksion një formë e veçantë është gramatikisht e domosdoshme për ta dalluar shquarsinë. Kur rasat i kanë funksionet e ndryshme, dhe përdoren në kontekste të ndryshme gramatikore, s'kanë nevojë edhe për format e ndryshme morfologjike dhe sinkretizohen formalisht për të mbajtur ekonominë gjuhësore maksimale.

⁴ Bëhet fjalë për termin linguistik "division of labor" (shq. "ndarje e punës").

Kjo tregon se si është përdorur sinkretizmi i rasave në morfologjinë e shqipes si mjet për të mbajtur numrin e formave të ndryshme të emrit në nivelin optimal sa i përket përdorimit të tyre në gjymtyrët e caktuara të fjalisë. Sinkretizmi e mundëson që format e njëjta të emrit të shpërndahen në kontekstet e ndryshme gramatikore. Vetëm kur rasat e ndryshme konkurrojnë për të njëjtën funksion, atëherë dështon sinkretizmi dhe shfaqen format morfologjikisht të ndryshme. Por edhe këto në fakt mbështeten në kategorinë e shquarsisë, d.m.th. në dallimin mes trajtave të shquara dhe të pashquara të rasës së njëjtë, falë depërtimit të saj në sistemin rasor të shqipes, dhe kështu sërish zvogëlohet numri i duhur i formave të ndryshme deri në nivelin optimal. Gjuha shqipe karakterizohet me funksionalizimin optimal të trajtave morfologjikisht të ndryshme të rasës/shquarsisë së emrit, falë rolit që e luan sinkretizmi në rrafshin morfosintaktik të saj. Kështu dhe sinkretizmi i rasave në gjuhën shqipe mund të shpjegohet si një mjet i ekonomisë së gjuhës, i bazuar në ndarjen e punës edhe shpërndarjen plotësuese.

Nga kjo mund të nxjerrim përfundime të rëndësishme për gjuhësinë gjenerale, si dhe për atë ballkanike. Së pari, ndërsa sinkretizmi zakonisht përshkruhet thjesht nga aspekti formal, si një dukuri arbitrare paradigmatisht (p.sh. nga literatura klasike, mes tjerash khs. Baerman et al. 2005; Stump 2001), këtu shihet mirë se si sinkretizmi është motivuar edhe funksionalisht. Kjo tregon për një lidhje të ngushtë mes morfologjisë dhe sintaksës, ku format dhe paradigmat morfologjike motivohen nga ana e sintaksës. Gjuha shqipe i ka përfutur kështu maksimum dy ose tri trajta të ndryshme të emrit në kategoritë përkatëse të rasës e të shquarsisë, duke përdorur sinkretizimin si mjet për të niveluar numrin e trajtave funksionalisht të domosdoshme. Shkaku i sinkretizimit ose pasinkretizimit të formave rasore bëhet (*jo*) *domosdoshmëria funksionale* e dallimeve morfologjike midis tyre, ku roli i sinkretizmit është të prodhojë shpërndarjen optimale të formave morfologjike nëpër kontekstet e ndryshme funksionale. Për shkak të kësaj duket se dallimet (ashtu si edhe njëjësimit) formale nuk janë thjesht arbitrare, por janë motivuar funksionalisht.

Së dyti, për nga aspekti ballkanik, duket se sinkretizimi i formave rasore (duke filluar me më të njohurin, ai i gjinore me dhanoren), që është motivuar nga sintaksa, u mundësua si i tillë historikisht me shfaqjen e kategorisë morfologjike të shquarsisë në gjuhët e Ballkanit, e cila u gramatikalizua në këto gjuhë si pjesë e lakimit. Vetëm duke u mbështetur në kategorinë e shquarsisë, e cila zuri vendin qendror në sistemin e lakimit duke marrë edhe disa funksione të rasave, morfosintaksa e gjuhëve ballkanike kishte mundësi ta zbatonte sinkretizmin e formave të trashëguara rasore, të organizohet funksionalisht në një mënyrë të re e të stabilizohet përsëri.

Bibliografia

- Agalliu, F., et. al. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe*, vol. I: *Morfologjia*. (Redaktor i vëllimit: prof. Shaban Demiraj; kryeredaktor: prof. Mahir Domi.) Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Ajeti, I. (2017). *Studime për gjuhën shqipe: Vepra të zgjedhura*. (Zgjedhi dhe përgatiti akademik Rexhep Ismajli.) Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Baerman, M. et al. (2005). *The Syntax-Morphology Interface: A Study of Syncretism*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Bokshi, B. (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. (Botim i dytë.) Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Booij, G. (1994). Against Split Morphology. In: *Yearbook of Morphology 1993* (G. Booij & J. Van Marle, eds.). Dordrecht: Kluwer, 27–49.
- Booij, G. (1996). Inherent versus Contextual Inflection and the Split Morphology Hypothesis. In: *Yearbook of Morphology 1995* (G. Booij & J. Van Marle, eds.). Dordrecht: Kluwer, 1–16.
- Çabej, E. (1955). Gjon Buzuku. *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës: Seria Shkencat Shoqërore* 3: 39–50.
- Krijezi, M. (2017). Problemet kryesore dhe llojet e gabimeve në mësimdhënien e shqipes si gjuhë e huaj. *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* 35: 253–263.
- Krijezi, M. & P. Mutavdžić (në këtë vëllim). Problematika razumevanja vida nominala u albanskom jeziku (prilog nastavi albanskog jezika kao stranog). Punim i prezantuar në kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare *Mapping Balkan routes 2*, Fakulteti Filologjik i Universitetit të Beogradit, tetor 2018.
- Stump, G. (2001). *Inflectional Morphology: A Theory of Paradigm Structure*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Topalli, K. (2007). Evolucioni i sistemit emëror në periudhën e shqipes së shkruar. *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* 26(1): 211–217.
- Turano, G. (në këtë vëllim). Lokativet dhe ekzistencialet në gjuhën shqipe. Punim i prezantuar në kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare *Mapping Balkan routes 2*, Fakulteti Filologjik i Universitetit të Beogradit, tetor 2018.

The Role of Case Syncretism in Albanian

Summary

The paper discusses the case system of Albanian, by focusing on the syncretism of the nominative and accusative on one hand, and the dative and ablative on the other. Case syncretism is analysed as a consequence and means of maintaining language economy as well as the division of labour between the competing morphological categories of case and definiteness.

Key words: case, syncretism, Albanian, nominal morphosyntax.